

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve
të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data

09.02.2019

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Totali	100	

Problemi 1

Kompania Komoditeti bënë prodhimin e dyshekëve dhe përmes rrjetit të dyqaneve të veta bënë shitjen e tyre në mbarë vendin. Dysheku më i kërkuar i kompanisë është dysheku MemoDream i cili prodhohet në 6 dimensione standarde. Kompania i cakton çmimet e veta të shitjes duke shtuar marzhën prej 10% mbi koston e plotë. Kostoja mesatare variabile për njësi është €160. Gjatë vitit 2018 në total janë shitur 36,000 copë të dyshekëve MemoDream, ndërsa fitimet e gjeneruara nga ky lloj i dyshekëve ishin në vlerën prej €684,000.

Gjatë përgatitjes së planeve për vitin 2019 u paraqiten propozime kontradiktore të menaxherit të marketingut dhe menaxherit të shitjes.

Menaxheri i marketingut paraqiti propozimin për shtimin e shpenzimeve të reklamës në vlerë prej €225,000. Sipas tij kjo do të mundësonte rritjen e shitjeve për 12% krahasuar me vitin 2018.

Në anën tjetër, menaxheri i shitjeve besonte se gjatë vitit 2019 shitjet e dyshekut MemoDream do të zvogëlohen dhe se vetëm 30,000 njësi mund të shiten. Ai kishte identifikuar se nga zvogëlimi i shitjeve respektivisht prodhimitarisë do të eliminohen kostot fikse në vlerë prej €75,000.

Kërkohe

1. Të llogaritet kostoja (mesatare) e plotë dhe çmimi (mesatar) i shitjes për njësi për vitin 2018. Sa ishte përqindja e marzhës mbi koston variabile? **6 pikë**
2. Të llogaritet fitimi (humbja) shtesë për vitin 2019 nëse pranohet propozimi i menaxherit të marketingut. Bazuar në rezultatin e arritur tregoni nëse duhet të pranohet propozimi i menaxherit të marketingut duke e arsyetuar rekomandimin tuaj. **5 pikë**
3. Nëse kompania vazhdon aktivitetin e saj duke u bazuar në propozimet e menaxherit të shitjes dhe dëshiron të mbajë marzhën prej 10% mbi koston e plotë dhe çmimin e njëjtë të shitjes, të llogaritet kostoja e synuar variabile për njësi. **5 pikë**
4. Çfarë është hendeku i kostos së synuar? Bazuar në rezultatin nën pikën 3, a ka hendek të kostos së synuar në kompaninë Komoditeti dhe nëse po, bëni të paktën dy rekomandime për mbylljen e hendekut. **4 pikë**

Zgjidhja

1. Llogaritja e kostos (mesatare) të plotë
Fitimi për njësi = Fitimi ÷ numri i njësive
= €684,000 ÷ 36,000
= **€19.00**

Kosto (mesatare) e plotë = Fitimi për njësi ÷ përqindja e marzhës mbi koston e plotë
= €19.00 ÷ 0.10
= **€190.00**

2 pikë

Llogaritja e çmimit (mesatar) të shitjes
Çmimi i shitjes = Kosto e plotë + Fitimi për njësi
= €190 + €19
= **€209.00**

2 pikë

Llogaritja e përqindjes së marzhës mbi koston variabile
Përqindja e marzhës mbi koston variabile = Fitimi për njësi ÷ Kosto variabile për njësi
= €19 ÷ €160
= **11.88%**

2 pikë

2. Propozimi i menaxherit të marketingut – Llogaritja e fitimit (humbjes)

Kontributi për njësi (€290 - €160)	€49.00
Rritja e numrit të njësive (36,000 njësi × 12%)	4,320 njësi
Rritja e përgjithshme e kontributit (€49 × 4,320 njësi)	€211,680
Shpenzimet shtesë të reklamës	€225,000
Fitimi/humbja (€211,680 - €225,000)	- €13,320

3 pikë

Propozimi i menaxherit të marketingut për rritjen e shpenzimeve të reklamës në vlerë prej €225,000 që do të ndikonte në rritjen e shitjeve prej 12% krahasuar me periudhën paraprake do të gjeneron një humbje të përgjithshme në vlerë prej €13,320 andaj Kompania Komoditeti **NUK** duhet të pranojë këtë propozim.

2 pikë

3. Propozimi i menaxherit të shitjes – Llogaritja e kostos së synuar variabile

Të hyrat nga shitja (30,000 njësi × €209)	€6,270,000.00
Kostoja e plotë (€6,270,000 ÷ 110%)	€5,700,000.00
Kosto e përgjithshme fikse (€1,080,000 - €75,000)	- €1,005,000.00
Kosto e përgjithshme e synuar variabile	€4,695,000.00
Numri i njësive	÷ <u>30,000</u>
Kosto e synuar variabile për njësi	€156.50

5 pikë

4. Hendeku i kostos së synuar

Hendeku i kostos së synuar është diferenca në mes të kostos së vlerësuar dhe kostos së synuar. Në rastin e Kompanisë Komoditeti hendeku i kostos është diferenca prej kostos variabile për njësi prej €160.00 dhe kostos së synuar variabile prej €156.50. Kjo diferencë krijon hendekun e kostos variabile prej €3.50 (€160,00 - €156.50) që duhet të mbyllet. **2 pikë**

Mbyllja e hendekun e kostos bëhet duke vendosur standarde me qëllim të përmirësimit të teknologjisë së prodhimit dhe proceseve duke përdorur teknika të ndryshme si në vijim:

- Zvogëlimin e numrit të përbërësve
- Përdorimi i forcës punuese më të lirë
- Përdorimi i përbërësve standard kudo që të jetë e mundur
- Blerje (marrje) të teknologjisë të re, më efikase
- Trajnimi i punëtorëve në teknikat më efikase
- Heqja (ndërprerja) e aktiviteteve të cilat nuk shtojnë vlerë
- Përdorimi i materialeve të ndryshme etj.

2 pikë

Problemi 2

Kompania Frigo bënë prodhimin e frigoriferëve vertikal dhe horizontal për nevoja të pastiqerive. Frigoriferët vertikal kanë derën nga xhami i plastifikuar i tejdukshëm dhe përdoren për ftohjen e pijeve freskuese ndërsa frigoriferët horizontal kanë kapak harkor të tejdukshëm dhe përdoren për akullore. Për vitin 2018 kompania kishte buxhetuar të prodhojë 4,500 frigorifer vertikal (FV) dhe 3,500 frigorifer horizontal (FH). Për montimin e elementeve të një FV duhet 6.5 orë të punës direkte ndërsa montimi i një FH kërkon 7.5 orë të punës direkte.

Kontabilisti menaxherial i kompanisë ka përgatitur të dhënat në vijim që kanë të bëjnë me ShPP-në:

- Shpenzimet vjetore fikse të punës indirekte janë në vlerën prej €62,000, ndërsa shpenzimet variabile për njësi janë €1.50 për orë të punës direkte
- Shpenzimet e energjisë elektrike kanë tarifën fikse mujore prej €350, ndërsa shpenzimet variabile për njësi janë €4.00 për orë të punës direkte
- Shpenzimet vjetore fikse të mirëmbajtjes janë në vlerën prej €35,000, ndërsa shpenzimet variabile për njësi janë €2.50 për orë të punës direkte
- Shpenzimet vjetore fikse të sigurisë në punë dhe mirëqenies së punëtorëve janë €24,000.
- Shpenzimet vjetore të qirasë janë €48,000.

Pas përfundimit të vitit 2018, kur kompania përfundoi përmbledhjen e aktiviteteve të saja rezultoi që numri i përgjithshëm i frigoriferëve të prodhuar ishte 8,500 prej të cilëve 60% ishin FH. ShPP-të aktuale janë:

Puna indirekte	€155,600
Energjia elektrike	€225,800
Mirëmbajtja	€185,500
Siguria në punë dhe mirëqenia e punëtorëve	€27,500
Qiraja	€48,000

Kërkohet:

1. Përgatitni një buxhet të ShPP-së për nivelin e buxhetuar të aktiviteteve për vitin 2018. **6 pikë**
2. Përgatitni buxhetin e ShPP-së për të dy produktet që pasqyron nivelin e aktivitetit prej 90% nga niveli i buxhetuar dhe një buxhet që pasqyron nivelin e aktivitetit prej 105% nga niveli i buxhetuar. **8 pikë**
3. Bazuar në rezultatet aktuale në fund të ciklit të prodhimit, përgatitni një raport të performancës për periudhën e ciklit të prodhimit. **6 pikë**

Zgjidhja

1.

Kompania Frigo

Buxheti i ShPP-së për vitin që përfundon me 31 dhjetor, 2018

	<u>Kosto për njësi</u>	<u>55,500 orë PD</u> ($6.5 \times 4,500$) + ($7.5 \times 3,500$) = 55,500
Kostot variabile:		
Mirëmbajtja	1.50	€83,250
Energjia elektrike	4.00	€222,000
Puna indirekte	2.50	€138,750
Gjithsej kosto variabile		<u>€444,000</u>
Kostot fikse:		
Mirëmbajtja		€62,000
Energjia elektrike (12 muaj x €350)		€4,200
Puna indirekte		€35,000
Siguria në punë dhe mirëqenia e punëtorëve		€24,000
Qiraja		<u>€48,000</u>
Gjithsej kosto fikse		<u>€173,200</u>
Gjithsej ShPP		<u>€617,200</u>

ose

	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer vertikal</u>	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer horizontal</u>	<u>Kosto</u> <u>fikse</u>	<u>Totali</u>
Mirëmbajtja	$1.5 \times (4,500 \times 6.5) = 43,875$	$1.5 \times (3,500 \times 7.5) = 39,375$	62,000	145,250
Energjia elektrike	$4.0 \times (4,500 \times 6.5) = 117,000$	$4.0 \times (3,500 \times 7.5) = 105,000$	4,200	226,200
Puna indirekte	$2.5 \times (4,500 \times 6.5) = 73,125$	$2.5 \times (3,500 \times 7.5) = 65,625$	35,000	173,750
Siguria në punë...	0	0	24,000	24,000
Qiraja	0	0	<u>48,000</u>	48,000
Gjithsej	<u>234,000</u>	<u>210,000</u>	<u>173,200</u>	<u>617,200</u>

6 pikë

2. Niveli i aktivitetit 90% nga niveli i buxhetuar:

Kompania Frigo

Buxheti i ShPP-së për vitin që përfundon me 31 dhjetor, 2018

	<u>Kosto për njësi</u>	<u>49,950 orë PD</u> ($55,500 \text{ orë PD} \times 90\% = 49,950$)
Kostot variabile:		
Mirëmbajtja	1.50	€74,925
Energjia elektrike	4.00	€199,800
Puna indirekte	2.50	€124,875
Gjithsej kosto variabile		<u>€399,600</u>
Kostot fikse:		
Mirëmbajtja		€62,000
Energjia elektrike (12 muaj x €350)		€4,200
Puna indirekte		€35,000
Siguria në punë dhe mirëqenia e punëtorëve		€24,000
Qiraja		<u>€48,000</u>
Gjithsej kosto fikse		<u>€173,200</u>
Gjithsej Shpenzime të përgjithshme		<u>€572,800</u>

ose

	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer vertikal</u>	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer horizontal</u>	<u>Kosto</u> <u>fikse</u>	<u>Totali</u>
Mirëmbajtja	$1.5 \times (4,050 \times 6.5) = 39,487.5$	$1.5 \times (3,150 \times 7.5) = 35,437.5$	62,000	136,925
Energjia elektrike	$4.0 \times (4,050 \times 6.5) = 105,300.0$	$4.0 \times (3,150 \times 7.5) = 94,500.0$	4,200	204,000
Puna indirekte	$2.5 \times (4,050 \times 6.5) = 65,812.5$	$2.5 \times (3,150 \times 7.5) = 59,062.5$	35,000	159,875
Siguria në punë...	0.0	0.0	24,000	24,000
Qiraja	0.0	0.0	48,000	48,000
Gjithsej	<u>210,600.0</u>	<u>189,000.0</u>	<u>173,200</u>	<u>572,800</u>

4 pikë

Niveli i aktivitetit 105% nga niveli i buxhetuar:

Kompania Frigo
Buxheti i ShPP-së për vitin që përfundon me 31 dhjetor, 2018

Kosto për njësi 58,275 orë PD (55,500 orë PD × 105% = 58,275)

Kostot variabile:			
Mirëmbajtja	1.50	€87,412.5	
Energjia elektrike	4.00	€233,100.0	
Puna indirekte	2.50	€145,687.5	
Gjithsej kosto variabile			<u>€466,200.0</u>
Kostot fikse:			
Mirëmbajtja		€62,000.0	
Energjia elektrike (12 muaj x €350)		€4,200.0	
Puna indirekte		€35,000.0	
Siguria në punë dhe mirëqenia e punëtorëve		€24,000.0	
Qiraja		€48,000.0	
Gjithsej kosto fikse			<u>€173,200.0</u>
Gjithsej ShPP			<u>€639,400.0</u>

ose

	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer vertikal</u>	<u>Kostot variabile</u> <u>Frigorifer horizontal</u>	<u>Kosto</u> <u>fikse</u>	<u>Totali</u>
Mirëmbajtja	$1.5 \times (4,725 \times 6.5) = 46,068.75$	$1.5 \times (3,675 \times 7.5) = 41,343.75$	62,000	149,412.5
Energjia elektrike	$4.0 \times (4,725 \times 6.5) = 122,850.00$	$4.0 \times (3,675 \times 7.5) = 110,250.00$	4,200	237,300.0
Puna indirekte	$2.5 \times (4,725 \times 6.5) = 76,781.25$	$2.5 \times (3,675 \times 7.5) = 68,906.25$	35,000	180,687.5
Siguria në punë...	0.00	0.00	24,000	24,000.0
Qiraja	0.00	0.00	48,000	48,000.0
Gjithsej	<u>245,700.00</u>	<u>189,000.00</u>	<u>173,200</u>	<u>639,400.0</u>

4 pikë

3.

Kompania Frigo
Buxheti i ShPP-së për vitin që përfundon me 31 dhjetor, 2018

	<u>Aktual</u>	<u>Buxheti</u>	<u>Mospërputhjet</u>	
	(a)	(b)	(c) = (a) – (b)	
Orë të PD për njësit e prodhuara*	60,350	60,350	0	
Kostot e prodhimitarisë:**				
Mirëmbajtja	€155,600	€152,525	€3,075	PF
Energjia elektrike	€225,800	€245,600	€19,800	F
Puna Indirekte	€185,500	€185,875	€375	F
Siguria në punë dhe mirëqenia...	€27,500	€24,000	€3,500	PF
Qiraja	<u>€48,000</u>	<u>€48,000</u>	<u>0</u>	
Totali	<u>€642,400</u>	<u>€656,000</u>	<u>€13,600</u>	F

6 pikë

* Vlerat e buxhetit fleksibil janë bazuar në 58,650 orë PD:

$$[(6.5 \times 3,400) + (7.5 \times 5,100)] = 60,350 \text{ orë PD}$$

** Kostot e prodhimitarisë

Mirëmbajtja $€62,000 + (€1.5 \times 60,350) = €152,525$

Energjia elektrike $(12 \text{ muaj} \times €350) + (€4.0 \times 60,350) = €245,600$

Puna indirekte $€35,000 + (€2.5 \times 60,350) = €185,875$

Problemi 3

3.a. Kompania Lux bënë prodhimin e elementeve të ndriçimit elektrik. Në njësinë për prodhimin e llambave ndriçuese në dy linja të ndara prodhohen llambadarët dhe llambat e tavolinës. Prodhimtaria kryesisht zhvillohet me makineri universale të marra në shfrytëzim të cilat lehtë mund të adaptohen për prodhimin e cilido prej produkteve. Të dhënat në vazhdim janë nxjerrë nga raportet financiare të kompanisë për muajin janar.

	<u>Llambadarë</u>	<u>Llamba tavoline</u>	<u>Totali</u>
Shitjet	37,000.00	15,000.00	52,000.00
Materialet direkte	15,500.00	6,500.00	22,000.00
Puna direkte	12,800.00	2,600.00	15,400.00
Qiraja për pajisje	3,000.00	3,150.00	6,150.00
Shpenzimet përgjithshme	e <u>1,800.00</u>	<u>1,950.00</u>	<u>3,750.00</u>
Fitimi operativ	3,900.00	800.00	4,700.00

Menaxhmenti i kompanisë po e shqyrton mundësinë e mbylljes së linjës për prodhimin e llambave të tavolinës. Me mbylljen e kësaj linje kompania nuk do të ketë nevojë për makinën speciale e cila përdoret vetëm në këtë linjë dhe për punëtorin i cili punonte në këtë makinë. Kompania paguante qiranë mujore për këtë makinë në vlerë prej €250 ndërsa paga e operuesit në makinën speciale ishte €600.

Në anën tjetër ri-alokimi i makinerisë dhe personelit tjetër të kësaj linje të transferoheshin në prodhimin e llambadarëve për të cilët ka kërkesë të mjaftueshme dhe pritjet që prodhimtaria e llambadarëve të shtohet për 50%.

Kërkohet

A duhet Kompania Lux të mbyllë apo jo linjën për prodhimin e llambave të tavolinës? Pse? Mbështeteni rekomandimin tuaj me llogaritjet përkatëse.

10 pikë

Zgjidhja

Ndikimi në fitimin e Kompanisë Lux nëse bëhet mbyllja e linjës për prodhimin e llambave të tavolinës

Shitjet

Rritja e të hyrave nga shitja e llambadarëve	€37,000 x 50%	€18,500	
Zvogëlimi i të hyrave nga shitja e llambave		<u>-€15,000</u>	
<i>Gjithsej ndikimi në të hyrat nga shitja</i>			€3,500

Shpenzimet variabile

Rritja e kostove të MD për llambadarë	€15,500 x 50%	-€7,750	
Rritja e kostove të PD për llambadarë	€12,800 x 50%	-€6,400	
Zvogëlimi i kostove të MD për llamba		€6,500	
Zvogëlimi i kostove të PD për llamba		<u>€2,600</u>	
<i>Gjithsej ndikimi në shpenzimet variabile</i>			-€5,050

Shpenzimet fikse

Zvogëlimi i kostove të qirasë		€250	
Zvogëlimi i kostove për punëtorin e larguar		<u>€600</u>	
<i>Gjithsej ndikimi në shpenzimet fikse</i>			<u>€800</u>
<i>Ndikimi në fitimin e kompanisë</i>	€3,500 - €5,050 + €800		-€700

Nëse Kompania Lux e mbyllë linjën për prodhimin e llambave të tavolinës, përkundër rritjes së prodhimit të llambadarëve për 50%, kompania do të pësoi rënie në fitim për €700, andaj i rekomandimi është se NUK duhet të mbyllet linja e prodhimit të llambave të tavolinës.

8 + 2 pikë

3.b. Një nga kompetencat për të përmbushur objektivat e performancës është grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave nga sistemet e të dhënave. Këto të dhëna formojnë raporte për Menaxhmentin dhe janë çelësi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e performancës. Andaj, është e domosdoshme që të merren në konsideratë burimet e të dhënave dhe procedurat që mund të jenë të nevojshme për të garantuar sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë.

Nga ana tjetër, shumë prej të dhënave të grumbulluara dhe të sistemuara janë të rëndësishme, të ndjeshme dhe nuk janë për konsum të jashtëm (jashtë organizatës) andaj shpesh herë atakohen nga hakerët përmes viruseve, spyware-ve dhe malware-ve etj. Për të garantuar siguri gjatë mirëmbajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave me besueshmëri të lartë është e nevojshme të zhvillohen procedura të ndryshme të sigurisë.

Kërkohet

Listoni dhe shpjegoni shkurtimisht pesë procedura për të garantuar sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë që nuk janë për konsum të jashtëm.

10 pikë

Zgjidhja

Për të garantuar sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë të cilat nuk janë për konsum të jashtëm mund të përdorë procedurat në vijim:

- Fjalëkalimet (passwords) - Fjalëkalimet janë një grup të i karaktereve të caktuara për një person, terminal ose pajisje që duhet të futen në sistem para se të lejohet qasja e mëtejshme. Në qoftë se karakteret e futura në sistem përputhen me fjalëkalimin e një përdoruesi të autorizuar ose është i vlefshëm për atë terminal të veçantë, sistemi lejon qasje, përndryshe sistemi mbyllet dhe mund të regjistrojë përpjekjet për qasje të paautorizuar.
- Sistemet me qasje logjike - kontrolli i qasjes logjike ka të bëjë me parandalimin e atyre të cilët kanë qasje në një terminal apo kompjuter, por që nuk janë të autorizuar të kenë hyrje në të dhëna ose softuerë të caktuar. Në një sistem me qasje logjike, qasja në të dhëna, softuerë, ose sisteme të veçanta kompjuterike, do të klasifikohen në bazë të ndjeshmërisë dhe besueshmërisë të të dhënave. Një sistem me qasje logjike kryen tri operacione kur kërkohet qasja (1) identifikimi i përdoruesit, (2) vërtetimi i identitetit të përdoruesit, (3) kontrollimi i autoritetit të përdoruesit
- Kontrollet e bazës së të dhënave - Bazat e të dhënave paraqesin problem të veçantë për sigurinë kompjuterike sepse, në bazën e të dhënave mund të kanë qasje një numër i madh i njerëzve, dhe kështu mundësia për ndryshime, zbulime të paautorizuara ose mashtrime është shumë më e madhe se me dosje/aplikacione të veçanta. Në bazat e të dhënave është e mundur të ndërtohen sisteme të komplikuar me fjalëkalim, dhe sistemi mund të programohet që të shfaqë përmbajtje të kufizuar për përdoruesit të caktuar, ose të kufizojë zbulimin e llojeve të caktuara të të dhënave. Gjithashtu është e mundur të ndërtohet një numër i privilegjeve në sistem, duke lejuar përdorues të autorizuar me fjalëkalim të veçantë, qasje në më shumë të dhëna.

- Firewall-et (muret prej zjarri) - Firewall-et bëjnë parandalimin e qasjeve të paautorizuara në sistemet e kompjuterike të kompanisë. Firewall-et mund të zbatohen edhe në harduer edhe në softuer, ose edhe në kombinimin e të dyjave. Firewall-et përdoren për të parandaluar përdoruesit e paautorizuar të internetit të kanë qasje në rrjetet private të lidhura në internet, e sidomos në Intranet. Të gjitha mesazhet që hyjnë ose dalin nga Intranet-i kalojnë përmes firewall-it, i cili shqyrton çdo mesazh dhe bllokon ato që nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara të sigurisë.
- Kodimi/kriptimi - Për të garantuar sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë të cilat nuk janë për konsum të jashtëm, ato mund të jenë të koduara (të shtrembëruara) në përpjekje për t'i bërë ato të pakuptueshme për përgjuesit, sepse të dhënat e transmetuara nga një pjesë e një organizate në një pjesë tjetër mund të zbulohen dhe kapen nga personeli i paautorizuar për qasje në ato të dhëna.
- Autenticiteti (Kontrolli i mirëfilltë) - është një teknikë për tu siguruar se një mesazh ka ardhur nga një dërgues i autorizuar.
- Sigurimi me thirrje kthyesë - vepron duke kërkuar nga personi që dëshiron qasje në rrjet të thërret dhe ta identifikojnë veten fillimisht. Sistemi pastaj i bënë thirrjen kthyesë personit në numrin e tij të autorizuar para se t'ia lejon qasjen.
- Planifikimi i sigurisë së personelit - Siguria duhet të varet nga numri më i vogël i mundshëm i personelit, por kjo shpesh herë nuk e mundshme të bëhet sepse shumica e punonjësve kanë qasje në rrjetet kompjuterike dhe pothuajse të gjithë të punësuarit mund të jetë në pozitë për të bërë dëme në sistemin kompjuterik, andaj është e nevojshëm të bëhet planifikimi i sigurisë së personelit. Planifikimi i sigurisë së personelit nënkupton ndërmarrjen e masave të caktuara si (1) rekrutimin e kujdesshëm, (2) rotacionin e pozitës, (3) mbikëqyrjen dhe vëzhgimin nga eprori, (4) rishikimi i përdorimit të kompjuterit, (5) pushimet e detyruara etj.
- Softuer anti-virus dhe anti-spyware - Virusi është një program kompjuterik i vetë-riprodhueshëm që infiltrohet dhe pastaj dëmton sistemin kompjuter, ndërsa spyware është një lloj programi që shikon atë që përdoruesit e bëjnë në kompjuterin e tyre dhe pastaj i dërgon këto informata përmes internetit te pala e tretë, andaj paraqesin rrezik për sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë. Për të eliminuar rrezikun nga ta 'dëmtues' janë zhvilluar softuerë anti-virus dhe anti-spyware për të luftuar këto rreziqe. Softueri anti-virus i lufton këto rreziqe (1) duke analizuar dosjet për të gjetur viruset e njohur (2) duke identifikuar sjelljet e dyshimta nga secili program kompjuterik që mund të shfaq shenja të infektimit. Softueri anti-spyware lufton spyware-ët (1) duke bërë mbrojtje në kohë reale që bëjnë parandalimin e instalimit të spyware-it duke e bllokuar softuerin dhe aktivitetet e njohura të cilët përfaqësojnë spyware-ët (2) duke zbuluar dhe larguar spyware-ët me skanimin e kohëpaskohshëm të sistemeve kompjuterike dhe softuerëve duke i hequr dosjet dhe shënimet që përputhen me spyware-ët e njohur. **Nga 2 pikë për secilën përgjigje, maksimum 10 pikë .**

Problemi 4

Kompania Komoditeti bënë prodhimin dhe shitjen edhe të jastëkëve Anatomik dhe Ergonomik të cilët prodhohen prej shpuzës elastike 'memory'. Për tremujorin e fundit të vitit 2018 kompania ka buxhetuar të dhënat në vijim:

Të dhënat e buxhetuara për tremujorin 4

<u>Produkti</u>	<u>Shitjet (njësi)</u>	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>Kosto variabile</u>
Jastëkë anatomik	35,100	9.00	5.00
Jastëkë ergonomik	42,900	8.50	4.00

Numri i përgjithshëm i jastëkëve për shitje për tremujorin e katërt është buxhetuar duke supozuar se Kompania Komoditeti mbanë 15% të pjesës së tregut në vend. Kërkesa e përgjithshme vjetore e tregut vendor për jastëk të tillë është vlerësuar në 2,080,000 njësi e shpërndarë në mënyrë të barabartë për secilin tremujor.

Të dhënat aktuale kanë treguar se kërkesa e përgjithshme vjetore për jastëk gjatë vitit 2018 ishte 2,300,000 njësi e shpërndarë në mënyrë të barabartë për secilin tremujor, ndërsa gjatë tremujorit të katërt Kompania Komoditeti kishte realizuar këto të dhëna

Të dhënat aktuale për tremujorin 4

<u>Produkti</u>	<u>Shitjet (njësi)</u>	<u>Çmimi i shitjes</u>	<u>Kosto variabile</u>
Jastëkë anatomik	33,810	9.50	5.30
Jastëkë ergonomik	46,690	8.00	3.75

Kërkohet

1. Të llogaritet mospërputhja e përgjithshme e vëllimit të shitjes, mospërputhja e përgjithshme e përzierjes së shitjeve dhe mospërputhja e përgjithshme e sasisë së shitjeve. **9 pikë**
2. Të llogaritet mospërputhja e madhësisë së tregut (mospërputhja e planifikimit në vëllimin e shitjes) dhe mospërputhja e pjesës së tregut (mospërputhja e operacioneve në vëllimin e shitjes) duke përdorur të dhënat e përmbledhura (në kumulativ) për dy llojet e jastëkëve. **6 pikë**
3. Komentoni rezultatet nga pika 1 dhe 2. **5 pikë**

Zgjidhja

1. Llogaritja e mospërputhjes së përgjithshme e vëllimit të shitjes, mospërputhjes së përgjithshme të përzierjes së shitjeve dhe mospërputhjes së përgjithshme e sasisë së shitjeve

Buxheti për tremujorin 4

	<u>Çmimi</u>	<u>Kosto variable</u>	<u>Kontributi</u>	<u>Njësiti e shitura</u>	<u>Përzierja e shitjeve</u>	<u>Gjithsej kontributi</u>
Jastëku anatomik	9.00	5.00	4.00	35,100	45.00%	140,400.00
Jastëku ergonomik	8.50	4.00	4.50	<u>42,900</u>	<u>55.00%</u>	<u>193,050.00</u>
Gjithsej				78,000	100.00%	333,450.00

Rezultatet aktuale për tremujorin 4

	<u>Çmimi</u>	<u>Kosto variable</u>	<u>Kontributi</u>	<u>Njësiti e shitura</u>	<u>Përzierja e shitjeve</u>	<u>Gjithsej kontributi</u>
Jastëku anatomik	9.50	5.30	4.20	33,810	42.00%	142,002.00
Jastëku ergonomik	8.00	3.75	4.25	46,690	58.00%	198,432.50
Gjithsej				80,500	100.00%	340,434.50

Mospërputhja e përgjithshme e vëllimit të shitjes

	<u>Njësiti e shitura</u> <i>a</i>	<u>Njësiti e buxhetuara</u> <i>b</i>	<u>Kontributi i buxhetuar</u> <i>c</i>	<u>Mospërputhja në njësi</u> <i>d (a - b)</i>	<u>Mospërputhja në Euro</u> <i>e (d x c)</i>
Jastëku anatomik	33,810	35,100	4.00	-1,290 PF	-5,160.00 PF
Jastëku ergonomik	46,690	42,900	4.50	3,790 F	<u>17,055.00 F</u>
					11,895.00 F

Mospërputhja e përgjithshme e përzierjes së shitjeve

	<u>Përzierja aktuale e shitjeve</u> <i>a</i>	<u>Përzierja standarde e shitjeve</u> <i>b</i>	<u>Kontributi i buxhetuar</u> <i>c</i>	<u>Mospërputhja në njësi</u> <i>d (a - b)</i>	<u>Mospërputhja në Euro</u> <i>e (d x c)</i>
Jastëku anatomik	33,810	36,225 *	4.00	-2,415 PF	-9,660.00 PF
Jastëku ergonomik	<u>46,690</u>	<u>44,275 **</u>	4.50	<u>2,415 F</u>	<u>10,867.50 F</u>
	80,500	80,500		0	1,207.50 F

* $80,500 \times 45\%$ (përzierja e buxhetuar) = 36,225 njësi

** $80,500 \times 55\%$ (përzierja e buxhetuar) = 44,275 njësi

Mospërputhja e përgjithshme e sasisë së shitjeve

Shitjet totale të buxhetuara (njësi)	78,000
Shitjet totale aktuale (njësi)	<u>80,500</u>
Mospërputhja e sasisë së shitjeve në njësi	2,500 F
Kontributi standard mesatar i ponderuar për njësi (€333,450 ÷ 78,000 njësi)	<u>€4.275</u>
Mospërputhja e sasisë së shitjeve në €	€10,687.50 F

9 pikë

2. Llogaritja e mospërputhjes së madhësisë së tregut dhe mospërputhjes së pjesës së tregut.

Madhësia vjetore e buxhetuar e tregut	2,080,000 njësi	
Madhësia e buxhetuar e tregut për tremujorin 4 (2,080,000 ÷ 4)	520,000 njësi	
Madhësia vjetore aktuale e tregut	2,300,000 njësi	
Madhësia aktuale e tregut për tremujorin 4 (2,300,000 ÷ 4)	575,000 njësi	
	<u>Buxheti</u>	<u>Aktuale</u>
Madhësia e tregut (T4)	520,000	575,000
Pjesa e tregut e Kompanisë Komoditeti	78,000	80,500
Përqindja	15%	14%

Mospërputhja e madhësisë së tregut

Përqindja e buxhetuar e madhësisë së tregut	15%
Përqindja aktuale e madhësisë së tregut	<u>14%</u>
Mospërputhja në përqindje e madhësisë së tregut	1% PF
Madhësia aktuale e tregut në njësi	575,000
Mospërputhja e madhësisë së tregut në njësi (575,000 x 1%)	5,750 PF
Kontributi standard	<u>€4.275</u>
Mospërputhja e madhësisë së tregut në Euro (5,750 njësi x €4.275)	€24,581.25 PF

Mospërputhja e pjesës së tregut

Madhësia aktuale e tregut në njësi	575,000
Madhësia e buxhetuar e tregut në njësi	<u>520,000</u>
Mospërputhja në njësi e madhësisë së tregut	55,000 F
Përqindja e buxhetuar e madhësisë së tregut	15%
Mospërputhja e pjesës së tregut në njësi (55,000 x 15%)	8,250 F
Kontributi standard	<u>€4.275</u>
Mospërputhja e pjesës së tregut në Euro (8,250 njësi x €4.275)	€35,268.75 F

Mospërputhja sasisë së shitjeve = Mospërputhja e madhësisë së tregut + Mospërputhja e pjesës së tregut
 €10,687,50 (F) = €24,581.25 (PF) + €35,268.75 (F)

6 pikë

3. Komentimi i rezultateve

Mospërputhja e vëllimit të shitjes = Mospërputhja e përzierjes së shitjeve + Mospërputhja sasisë së shitjeve
 $€11,895.00 (F) = €1,207.50 (F) + €10,687.50 (F)$

Mospërputhja sasisë së shitjeve = Mospërputhja e madhësisë së tregut + Mospërputhja e pjesës së tregut
 $€10,687,50 (F) = €24,581.25 (PF) + €35,268.75 (F)$

Për komentet me tekst që i tregojnë ndërlidhjet në mes të mospërputhje 2 x 2.5 = 5 pikë

Problemi 5

Kompania Druri bënë prodhimin e dy llojeve të tavolinave; tavolina të kuzhinës (TK) dhe tavolina për zyra (TZ). Çdo produkt duhet të përpunohet nëpër departamentin e prerjes (DP), departamentin e formësimit (DF) dhe departamentin e montimit (DM). Koha e nevojshme e punës për secilin lloj të produkteve në secilin departament është paraqitur në vijim.

	<u>Prerja</u>	<u>Formësimi</u>	<u>Montimi</u>
Tavolina për kuzhinë	5 min.	18 min.	4 min.
Tavolina për zyra	12 min.	10 min.	4 min.

Gjatë javë së dytë të shkurtit janë në dispozicion 50 orë për departamentin e prerjes, 75 orë në departamentin formësimit dhe 20 orë në departamentin e montimit. Tavolinat e kuzhinës shitet me çmim €300 dhe kostoja e materialeve dhe punës është €180, ndërsa tavolinat për zyra shitet me çmim €220 dhe kostoja e materialeve dhe punës është €140.

Kërkohe

Të bëhet paraqitja grafike e kufizimeve dhe kombinimin e numrit (të rrumbullakuar në numrin më të përafërt të plotë) të tavolinave të kuzhinës dhe tavolinave për zyra që duhet të prodhohen dhe shiten për të maksimizuar fitimin. Sa është vlera e fitimit?

20 pikë

Zgjidhja

1. Definimi i variablave

Le të jetë: X = numri i njësisve të tavolinave të kuzhinës

Le të jetë: Y = numri i njësisve të tavolinave për zyra

1 pikë

2. Funksioni objektiv:

$$\text{Fitimi}_{(\max)} = 120x + 80y$$

Kufizimet:

Departamenti i prerjes (1) $5x + 12y \leq 3,000$

Departamenti i formësimit (2) $18x + 10y \leq 4,500$

Departamenti i montimit (3) $4x + 4y \leq 1,200$

Kufizimet e nënkuptuara: (4) $x \geq 0$

(5) $y \geq 0$

1 pikë

3. Paraqitja grafike

(1) $5x + 12y = 3,000$

x		0		600
y		250		0

(2) $18x + 10y = 4,500$

x		0		250
y		450		0

(3) $4x + 4y = 1,200$

x		0		300
y		300		0

2 pikë

4. Përcaktimi i vijës së iso-kontributit

Funksioni objektiv:

$$\text{Fitimi}_{(\max)} = 120x + 80y$$

supozojmë se


$$120x + 80y = 12,000$$

atëherë

x		0		100
y		150		0

2 pikë

5. Paraqitja grafike



10 pikë

6. Maksimizimi i fitimit

Maksimizimi i fitimit bëhet në pikë-prerjen e grafikëve:

- (a) $18x + 10y = 4,500$ / $\times 2$ (shumëzojmë funksionin (a) me 2)
- (b) $4x + 4y = 1,200$ / $\times 5$ (shumëzojmë funksionin (b) me 5)

atëherë

- (a) $36x + 20y = 9,000$
- (b) $20x + 20y = 6,000$ / e zbresim funksioni (b) nga funksioni (a)

$$16x = 3,000$$

$$x = 187.5$$

Zëvendësojmë vlerën e $x = 187.5$ në njërin prej funksioneve

$$4x + 4y = 1,200$$

$$(4 \times 187.5) + 4y = 1,200$$

$$4y = 1,200 - 750$$

$$4y = 450$$

$$Y = 112.5$$

Maksimizimi i fitimit

$$F_{(\max)} = 120x + 80y \text{ kur } x = 187.5 \text{ dhe } y = 112.5$$

$$F_{(\max)} = (120 \times 187.5) + (80 \times 112.5)$$

$$F_{(\max)} = €22,500 + €9,000$$

$$F_{(\max)} = \mathbf{€31,500}$$

4 pikë

Fletë për ushtrime - Mos e paraqitni zgjidhjen këtu

Fletë për ushtrime - Mos e paraqitni zgjidhjen këtu

Fletë për ushtrime - Mos e paraqitni zgjidhjen këtu

